

AKT THEMELIMI  
DHE STATUTI I  
SHOQERISE TREGTARE

“RS-Elektrik” shpk.

Sot me date 12.04.2024, Ortaku themelues;

- ▶ Zt. Rigels Skendo i biri i Rexhepit, lindur ne Sarande me 18.02.1988, banues ne Tirane, Rmadhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me ID: I80218051R nepermjet ketij akti themelimi e statuti ka vendosur krijimin e Shoqerise Tregtare “RS-Elektrik” shpk shpk. me kushtet e meposhteme:

Neni 1

Shoqeria Tregtare “RS-Elektrik” shpk k. krijohet si shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, bazuar ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, me gjithe ndryshimet perkatese.  
Ajo eshte Person Juridik Shqiptar.

Neni 2

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.  
Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 3

Shoqëria “RS-Elektrik” shpk e ka selinë e saj në qytetin e Tiranës, në adresën; **Adresa: Rr. “Migjeni”, Nd. 23, H.15, Ap 20, Yzberish, Njesia Administrative Kashar, Tirane. Kutia Postare 1050.**  
Ajo mund të çele dhe seli të tjera të dyta dege e filiale përfaqësi dhe agjensi operative në të gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Neni 4

Veprimtaria e shoqërisë bazohet në normat e këtij Akti Themelimi, Statutin e Shoqërisë, si dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi.  
Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të papërcaktuar. Veprimtaria e shoqërisë fillon pas regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së saj do të jetë; **Tregëti me pakice të materialeve elektrike, punime në sisteme elektrike civile dhe industriale, montime të sistemeve fotovoltaike.**

KREU I

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njqind mijë) leke dhe përbehet nga 1 kuota me vlerë të përgjithshme 100,000 leke, me kontribute të ortakëve si më poshtë:

- Zt. Rigels Skendo zoteron 1 kuota me vlerë të përgjithshme 100,000 leke e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë të nënshkrueshme dhe të shlyeshme krejtësisht.

Çdo kuota i takon e drejtë e një vote.

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të paksohet sipas vendimeve të asamblese së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

Ortakët mund t'i shesin kuotat të tretëve pjesërishte ose tërësishtë

Neni 7:

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje shoqëria "RS-Elektrik" shpk

Neni 8:

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë

-Asambleja e ortakëve

-Administratori

Fusha e veprimt, përbërja dhe mënyrat e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

Neni 9:

Administrator i Shoqërisë "RS-Elektrik" shpk shpk. caktohet për një periudhë 5 (pese) vjeçare nga data 12.04.2024 deri më 11.04.2029.

**Zt. Rigels Skendo i biri i Rexhepit, lindur në Sarandë më 18.02.1988, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, i identifikuar me ID nr: I80218051R.**

Neni 10:

Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe tërheqja e kuotave të papaguara

- (1) Administratoret mund t'u kërkojnë ortakëve të paguajnë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej, të paktën, katërmbëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, sic përcaktohet në njoftim.
- (2) Nëse do të ketë zotërues të përbashkët të një kuote, ata mbajnë përgjegjësi bashkërisht dhe veçmas për të përbushur shlyerjet e përcaktuara në thirrjet përkatëse për pagesë të kontributit të cilat lidhen me këto kuote.
- (3) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratorët mund t'i japin një njoftim prej jo më pak se katërmbëdhjetë ditësh të plotë personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajnë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe përcaktohet se në rast moszbatimi, kuotat me të cilat lidhet njoftimi për pagesë do të anulohen.
- (4) Nëse njoftimi nuk respektohet dhe pagesa nuk ekzekutohet edhe pas këtij njoftimi, atëherë kuotat përkatëse mund të tërhiqen me vendim të Administratoreve dhe tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendet ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.
- (5) Nëse baze të një vendimi të Administratoreve (ose Administratorit kur është një administrator) kuota ose kuotat e tërhequra mund të shitin ose të rishpërdahen.
- (6) Personi prej të cilit janë tërhequr kuotat e kapitalit pushon që qeni ortak në lidhje me kuotat e tërhequra por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e tërheqjes së tyre, plus interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara tërheqjes.

Neni 11:

Kuotat, të drejtat dhe kufizimet

Cdo kuota mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla sic përcaktohet në vendimin e kualifikuar (me tri të katërtat e votës) të Asamblese së Përgjithshme.

Neni 12:

Certifikatat e kuotave të kapitalit

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të leshojë me shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave. Emrat e zotëruësve të përbashkët renditen në certifikatën e kuotes. Ky vertetim nuk ka natyrën e letres me vlerë.

Neni 13:

Kalimi i kuotave me kontratë

- (1) Kontrata e kalimit të kuotes bëhet me shkrim ose me akt noterial dhe regjistrohet në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Asnjë ortak nuk mund të disponojë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotave përkatëse dhe/ose nuk mund të tjetërsojë këto kuota nëse nuk ka shlyer të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i tyre.

Neni 14:

Kalimi përmes trashëgimisë

(1) Nëse një ortak vdes bashkëzotuesit e mbetur gjalle dhe, në rastin kur është zotëruar i vetëm ose një bashkëzotues i vetëm i mbetur gjalle, trashëgimtaret e tij janë të vetmit persona të cilet shoqëria i njeh si titullare të kuotës së tij. Por në asnjë rast, ky fakt nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga detyrimet që lidhen me kuotën që ka pasur në zotërim të vetëm ose bashkërisht.

Neni 15:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

(1) Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar (3/4), duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues me shumicë që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohej edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

(2) Me anë të një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e vet në vlerat dhe kriteret e përcaktuara me vendim të kualifikuar.

Kreu II

Asambleja e Përgjithshme

Neni 16:

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e ortakëve do të thirret nga administratoret të paktën njëherë në vit në seline të Shoqërisë ose në çdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.

(2) Gjithashtu, ortakët të cilet përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratoreve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratoreve mund të përfshihen dhe çështjet e posaçme të rendit të ditës.

(3) Asambleja e ortakëve do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratoret, njoftim ky i cili duhet të merret nga të gjithë ortakët ose përfaqësuesit e tyre nëpërmjet një letre rekomande, jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes.

(4) Ftesa për takimin e asamblës së ortakëve do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës dhe, në rastin e një asamblëje të zakonshme të ortakëve do të përfshijë gjithashtu dhe pasqyrat financiare dhe raportin e administrimit.

(5) Nëse dita për mbledhjen e ardhshme të asamblës është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohej sikur njoftimi është dërguar.

(6) Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 17:

Të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendim-marrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.

(2) Asambleja e Përgjithshme përbehet nga të gjithë ortakët.

(3) Vetëm asambleja e ortakëve ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:

- ▶ ndryshime dhe modifikime të Statutit;
- ▶ pranimin e ortakëve të rinj (pasi rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
- ▶ vendimin mbi përjashtimin e një ortakut në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;
- ▶ të japë të drejta nënshkrimi dhe/ose mundësi zëvendësimi për kuotat në shoqëri.
- ▶ zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar dhe/ose çdo lloj pagimi të pjesëmarrësve ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
- ▶ bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- ▶ blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- ▶ hapjen dhe mbylljen e degëve dhe përfaqësive;
- ▶ miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërive si dhe shpendarjen e fitimit;
- ▶ blerjen, shitjen dhe dhënie peng të pasurive të paluajtshme;

- ▶ marrjen me qira, dhenien me qira ose dhenien e cdo të drejte per perdorimin e pasurive të paluajshme dhe ndertesave;
- ▶ të vendose per investimet;
- ▶ të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të leshoje garanci ose letra sigurie;
- ▶ te percaktoje parimet e pergjithshme te politikave te shoqerise;
- ▶ te jape dhe te heqe (revokojë) prokura ose autorizime per te vepruar ne emer te shoqerise.
- ▶ te caktojë shperblimet per administratoret, te perfundojë kontratat e sherbimit me administratoret dhe nepunesit ekzekutive te shoqerise.
- ▶ te jape alternativa, të drejta te ndarjes se fitimit vjetor, pagesave ne natyre, te drejtat mbi pensionet ose çdo pagese mbi largimin e
- ▶ drejtove, dhe nepunesve ekzekutive te shoqerise;
- ▶ te perfundojë marreveshje konsultimi dhe bashkepunimi;
- ▶ caktimin e auditoreve, eksperteve kontabel dhe likuiduesve;
- ▶ miratimin e rregullave te brendshme mbi administrimin;
- ▶ ngritjen e padive kunder anetareve te organeve te Shoqerise apo ortakeve;
- ▶ percaktimin e struktures organizative dhe administrative te Shoqerise;
- ▶ percaktimin e buxhetit vjetor;
- ▶ miratimin e cdo çeshtje tjeter zgjidhja e se ciles i eshte rezervuar asamblese se ortakeve ne perputhje me ligjin dhe kete Statut.

(4) Ne cdo rast asambleja e ortakeve do te kete te drejte të vendose mbi cdo ceshtje qe tejkalon aktivitetin e perditshem te shoqerise.

#### Neni 18:

##### Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Pergjithshme cakton nje Kryetar per të drejtuar punimet e mbledhjes dhe nje person per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

Ky vendim merret me shumice te thjeshte.

(2) Vendimet duhen aprovuar permes votimit te Asamblese merren me vote te hapur, nese, perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk eshte kerkuar ne menyre te rregullt nje votim i fshehte. Votimin e fshehte mund ta kerkoje:

1. Kryetari; ose

2. Njo ortak ose disa ortake qe perfaqesojne jo me pak se pese perqind te votave gjithsej te asamblese se shoqerise.

(3) Vendimet ne asamblene e ortakeve te cilat kerkojne nje shumice te zakonshme mund te merren vetem nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave. Vendimet ne asamblese e pergjithshme te cilat kerkojne shumice te kualifikuar mund te merren vetem nese jane te pranishem ortaket te cilet zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

(4) Prokura duhet te jete e noterizuar dhe te paraqitet ne mbledhjen e ortakeve. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

(5) cdo ortak ka to drejte te therrase keshilltare ne mbledhjen e ortakeve, te cilat do te jenë te detyruar te ruajne fshehtesine e mbledhjes.

(6) Nese mbledhja e ortakeve thirret ne menyre te rregullt por nuk plotesohet numri i ortakeve te caktuar per te permbushur kuorumin, atehere asambleja do to thirret perseri ne perputhje me te njejten procedure, por gjithmone jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite.

#### Neni 19:

##### Votat e ortakeve

(1) Ne varesi te te drejtave ose kufizimeve te lidhura me kuotat, secila kuote e nje ortaku i cili (si individ) eshte i pranishem vete ose permes nje prokure perfaqesimi ose (si shoqeri) eshte i pranishem permes perfaqesuesit të autorizuar ne menyre te rregullt ose permes nje prokure perfaqesimi ka te drejten e nje vote.

(2) Asnje ortak nuk ka drejten e votes ne mbledhjen e Asamblese së Pergjithshme personalisht ose permes nje prokure perfaqesimi, në lidhje me kuotat që zoteron vete, nese nuk jane paguar teresisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuoten në fjale.

(3) Kundershtimet e ngritura per plotesimin e kushteve nga ana e nje votuesi i behen ne kohe Kryetarit, vendimi i te cilit, eshte i formes së prerë.

(4) Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato ceshtje të cilat janë percaktuar shprehimisht në rendin e dites për mbledhjen e ortakeve. Diskutimet mbi ceshtje të ndryshme nga ato të rendit të dites mund të behen vetëm nëse të gjithë ortaket japin pelqimin e tyre.

Neni 20:

Procesverbali i mbledhjes së ortakëve

(1) Për çdo mbledhje të ortakëve do të mbahet një procesverbal. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqerine, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin ortak. Procesverbali i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme, kur është rasti.

(2) Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe kundersfirmoset nga sekretari që e mban atë, si dhe nga të gjithë pjesëmarrësit e tjere në mënyrë fakultative.

(3) Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit të shpërndajen e tij.

Kreu III

Administratoret

Neni 21:

Administrimi dhe emërimi i administratorëve

(1) Administrimi i shoqërisë do të behet nga një administrator, i cili do të përfaqësojë Shoqerine individualisht, Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që administrimi i shoqërisë mund të behet nga 2 ose më shumë administratorë. Emërimi i nënshtrohet individualisht një vendimi të zakonshëm i cili, nëse miratohet, con në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.

(2) Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqerine në të gjitha ceshtjet që kanë lidhje me të, duke patur parasysh kufizimet në tagrat e tij.

(3) Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

(4) Duke marrë parasysh kufizimet e vendosura me këtë Statut, administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt paleve të treta dhe shtetit;
- (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- (c) marrjen e huave në emër të Shoqërisë të vendosjen e kushteve;
- (d) përfundimin e marrëveshjeve mbi dënimin e huave deri në limitin e mesipër;
- (e) përfundimin e marrëveshjeve me palet të treta, leshimin dhe marrjen e urdher pagesave;
- (f) nënshtrohet të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhe të huaja, flete ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palet të treta;
- (g) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dënimin dhe marrjen e paradhënies;
- (h) dënimin e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasoje e marrëdhënies të Shoqërisë me palet të treta dhe/ose pranimin e ketyre padive;
- (i) pënesimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- (j) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen për sipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratoret mund të udhëzojnë avokatet të mbrojnë Shoqerine dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratoret kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i terheqin ato, të nënshtrojnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të terheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet.
- (k) administratoret kanë të drejtë marrin çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikepamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (l) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- (m) administratoret janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;

- (n) administratoret jane pergjegjes per pergatitjen dhe nenshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare te Shoqerise dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtem nëse diçka e tille kerkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakeve;
  - (o) thirrjen e mbledhjeve të ortakeve; percaktimin e rendit te dites; monitorimin e permbushjes së dispozitave qe kane lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes se ortakeve per shpalljen e vendimeve të vecanta;
  - (p) publikimin e shpalljeve të nevojshme perfshire dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
  - (q) administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit te Shoqerise;
  - (r) marrin vendime mbi të gjitha ceshtjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshem te Shoqerise dhe marredheniet e saj te jashtme.
  - (s)
- (5) Personi i meposhtem do te caktohet administrator per një periudhe 5 (pese) vjeçare me të drejte ripërteritjeje:

**Zt. Rigels Skendo i biri i Rexhepit, lindur ne Sarande me 18.02.1988, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me ID nr:I80218051R.**

Neni 22:

Shkarkimi dhe largimi i administratoreve

(1) Posti i Administratorit lirohet nëse:

- • Pushon se qeni Administrator ne baze te dispozitave te Ligjit perfshire Nenin 95 paragrafi (6) te Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Shkarkimi mund te behet per çdo lloj arsye, qe justifikon marrjen e vendimit te tille nga ana e Asamblese se Pergjithshme;
- • Vuan ose mund te vuajë nga çrregullime mendore;
- • Jep doreheqjen përmes nje njoftimi qe i ben shoqerise;

Neni 23:

Shperblimi i punes, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorove

(1) Administratoret kane te drejte te marrin shperblim per punen e tyre, sipas nje vendimi te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme.

Kreu IV

Dividendet dhe kapitalizimi i fitimeve

Neni 24: Dividendët

(1) Pasi Asambleja e Pergjithshme ka verifikuar se aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj dhe se shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim, shoqeria, me ane te nje vendimi te kualifikuar, mund te shpalle dividende ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakëve.

(2) Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe u lidhen kuotave, te gjithe dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumate e paguara per kuotat ne lidhje me të cilët paguhet dividendi. Te gjithe dividendet perpjesetohen dhe paguhen ne përpjestim me shumate e paguara per kuotat gjate pjeseve ose pjeseve të periudhes ne lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuota emetohen me kushtin se merr dividend duke filluar nga nje date e caktuar, atehere kuota në fjale e merr dividin sipas ketij kushti.

Kreu V

Viti Financiar, Bilanci, Fitimet dhe Humbjet

Neni 25:

Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

(1) Viti financiar i Shoqerise zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e pare te Janarit the mbaron në ditën e tridhjetë e nje të Dhjetorit. Viti i pare financiar i Shoqerisë fillon në datën e regjistrimit te Shoqerisë the mbaron në datën e tridhjetë e një-te të Dhjetorit te po atij viti.

(2) Ne find te çdo viti financiar, administratoret do të permbushin detyrat e meposhtme:  
(a) pergatitjen e nje liste të detajuar të aseteve te Shoqerise dhe struktures se tyre;

- (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;  
(c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- (3) Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblese së ortakëve së bashku me një raport të auditoreve të jashtëm për miratim.

Neni 26:

Fitimi i Shoqërisë

- (1) Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri si me poshte:
- ▶ 100% e fitimit do t'i shpërndahet ortakëve sipas përqindjeve në kapitalin themelues;
- (2) Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe kaktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajt Mars të vitit pasardhës.

Kreu VI

Prishja dhe likuidimi

Neni 27:

Prishja dhe likuidimi

- (1) Shoqëria do të priset në rastet e mëposhtme:
- • me vendim të mbledhjes së asamblese së ortakëve;
  - • nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër;
  - • mbi bazën e një vendimi të gjykates dhe për rastet e parashikuara me ligj;
  - • në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- (2) Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.
- (3) Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblese së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

Kreu VII

Neni 28:

Te përgjithshme

- (1) Në rast mosmarreveshjes të cilat lindin si pasoje e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortaket do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marreveshje, mosmarreveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion perkates.
- (2) Ligji i aplikueshem është ligji shqiptar
- (3) Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (kater) kopje origjinale.

ORTAKU THEMELUES

Rigels Skendo

Rigels Skendo

